

VENDIM
Nr.124, datë 2.3.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.337, DATË 15.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERITAR PËR PROBLEMET UJORE
ME VENDET FQINJE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 4, dhe 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ka në përbërje 9 përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve të Jashtme	anëtar,
- Ministria e Brendshme	anëtar,
- Ministria e Financave	anëtar,
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	anëtar,
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	anëtar,
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	anëtar,

- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
- Akademia e Shkencave	anëtar,
- Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit anëtar.”.	

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat), të përballohen nga buxheti i ministrave dhe institucioneve përkatëse.”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha